



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 30/1 Prot.

Tiranë, më 22/7/2011

**Lënda:** Rekomandim për **Gazeta “Sot”, Tiranë .**

### REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Gazeta “Sot”, Tiranë ,**

### KONSTATOVA

Më datë 16/06/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Gazeta “Sot”, Tiranë,** me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së z. A.T, lidhur me publikimin e të dhënave personale të të miturës në **Gazetën “Sot”,** më datë 29.05.2011.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi, Gazeta “Sot“, Tiranë në aktivitetin e vet mediatik, të shkruar, ka botuar në numrin e ditës së dielë, datë 29 Maj, 2011, artikullin me titull: **Adoleshentja nga Mulleti, prej 3 ditësh e “zhdukur”.** Më pas artikulli vijon:

**“Një 16 vjeçare e quajtur D.T, ka 3 ditë që është larguar nga shtëpia dhe nuk është kthyer më aty. Ndërkaq i shqetësuar për fatin e vajzës së tij, babai i saj një 36 vjeçar nga Mulleti i Tiranës ka denoncuar humbjen e saj në polici. A.T, 36 vjeç është paraqitur në komisariatit nr.4, në kryeqytet dhe ka denoncuar humbjen e vajzës.....”**

Kryeredaktorja e kësaj gazete pretendoi se, ky artikull ishte hedhur në gazetë sipas një komunikate për shtyp që Drejtoria e Policisë, Rajoni nr.4, Tiranë, të cilën ja kishte vënë në dispozicion jo vetëm Gazetës “Sot”, por dhe të disa gazetave të tjera, komunikatë që nuk na u vu në dispozicion, me pretendimin se burimi i informacionit nuk ishte zyrtar, por konfidencial.

Pas verifikimit të rastit konstatojmë se, informacionet e dhëna në artikull, nuk prezantojnë një element momentalisht të dobishëm me qëllim të lehtësimit të gjetjes së minores dhe përhapja e tyre nuk rezulton thelbësore për interesin publik.

Mbrojtja e dinjitetit dhe të drejtat e individit, janë të rëndësishme dhe për këtë vlen *limiti* i publikimit të fakteve të njohura nga të interesuarit.

**Gazetari**, duhet të vlerësojë në përgjegjësinë e tij, nëse përhapja e një të dhëne personale në fushën e një lajmi, është apo jo esenciale.

Përhapja e një të dhëne të caktuar, mund të jetë e nevojshme, kur njohja e saj nga ana e publikut, gjen justifikim në origjinalitetin e fakteve të treguara, në mënyrën se si, këto fakte janë zhvilluar në veçantinë e subjekteve që janë përfshirë në to.

Publikime të tilla nuk rezultojnë, konform dispozitave në fushën e mbrojtjes së privatësisë dhe personalitetit të subjektit të të dhënave, që në rastin në fjalë është një minorene. Trajtimi në fjalë është përqëndruar mbi një subjekt minoren që, parë dhe në këndvështrimin e parimeve të lirisë së informacionit, kërkon një mbrojtje të fortë me qëllim mos paragjykimin e rritjes harmonike të personalitetit të subjektit-minoren.

Duke patur parasysh ruajtjen e ekuilibrit delikat mes lirisë së informimit dhe mbrojtjes së privatësisë dhe për më tepër, kur është fjala për të mitur ose adoleshentë, theksojmë nevojën që, gazetarët të kryejnë një vlerësim të kujdesshëm mbi interesat objektive të të miturve apo adoleshentëve, kur publikojnë lajme lidhur me ta, edhe kur vihen në dijeni të tyre në rrugë zyrtare apo familjare.

Për diçka, duhet të bindemi: qytetarëve ju duhet një **gazetari**, më e kujdesshme, më e ndjeshme, dhe më pak cinike.

Sa më sipër, kontrolluesi, Gazeta “Sot“, Tiranë, nga publikimi i të dhënave personale të të miturës 16, vjeçare në një prej numrave të saj dhe konkretisht në atë të datës 29.05.2011, ka shkelur nenet 3, 5, 6 dhe 18, të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe aktin nënligjor të tij, Udhëzimin Nr. 9, datë 15/09/2010 **“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”**, i cili është mbështetur kryesisht në nenet 29 pika 1, 30 pika 1/c, këtij të ligji.

Gjithashtu, theksojme se, këtij kontrolluesi, i është dërguar një shkresë, pikërisht në lidhje me një artikull të kësaj gazete, në të cilën bëhej fjalë, sipas artikullshkruesit, pikërisht për dhunimin e privatësisë. Kjo shkresë daton në 21.04.2011, me nr.90 protokoli dhe, **Lënda:**Mbi artikullin e publikuar në datën 19.04.2011, në Gazeta “Sot”.



Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

### REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 te ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Gazeta “Sot”, Tiranë, duhet të hartojë rregulla të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar dhe ta publikojë atë online në faqen e saj zyrtare.
2. Të zbatohen parashikimet e Udhëzimit Nr. 9, datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Në respektim të nenit 8 të Konventës Europiane të Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, si dhe në përcaktimet e bëra në nenin 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, : ...”*kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë*”, sugjerojmë:
  - a. Ruajtjen e anonimatit të subjekteve të të dhënave, të cilët janë pjesë e lajmit, dhe sidomos kur është fjala për minoret apo adoleshentët.
  - b. Publikimin vetëm të inicialeve të subjekteve të të dhënave, të cilët janë pjesë e lajmit.
  - c. Minimizimin e të dhënave që identifikojnë subjektin, sa më shumë të jetë e mundur.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet menjëherë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI  
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**